



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I SHQIPËRISË**  
*Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

*Dokument parlamentar*

*Tiranë më 29.01.2019*

**RAPORT**

**PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT NR. 11063, DATË 19.01.2019, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR PROPOZIMIN E KRYETARIT TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT”**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 29.01.2019, u mbledh për të shqyrtuar dekretin e Presidentit të Republikës nr.11063, dt.19.01.2019, protokolluar në Kuvend me nr.234, dt.21.01.2019, “Për propozimin e zotit Bahri Shaqiri, Kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Ky është dekreti i dytë që propozohet për këtë pozicion kushtetues nga Presidenti i Republikës. Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr 126, dt.20.12.2018, rrëzoi Znj.Vitore Tusha, kandidaturë e parë e propozuar nga Presidenti.

Gjatë seancës dëgjimore, Z.Shaqiri paraqiti një ekspozë të vizionit të tij për këtë pozicion, rolin dhe prioritetet që ka një titullar, në këtë rast një kryetar i institucionit më të lartë të kontrollit ekonomiko-financiar në vend, atë të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Pas dëgjësës së kandidatit, Komisioni vijoi me shqyrtimin e Dekretit dhe kushteve ligjore që përcakton ligji 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH” për zgjedhjen e kryetarit të KLSH.

### ***Nga ana formale-ligjore :***

Dekreti i Presidentit vjen në përputhje me nenin nenit 93 dhe nenin 162, pika 2 të Kushtetutes se Republikes se Shqiperisë.

Dekreti është shoqëruar me shkresë përcjellëse si dhe dokumentacionin përkatës të depozituar nga vet kandidati gjatë procesit të aplikimeve të shpallur nga Presidenti në tetor 2018.

### ***Shqyrtimi parlamentar:***

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit, nenit 111 të saj, Kryetari i Kuvendit ia ka kaluar menjëherë propozimin përmes dekretit të Presidentit, Komisionit për Ekonominë dhe Financat me cilësinë e komisionit përgjegjës, i cili vendos nëse kandidatura plotëson kushtet ligjore.

Bazuar në pikën 7 të nenit 111 kësaj Rregulloreje, komisioni përgjegjës, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen, shqyrton përmbushjen e kriterëve kushtetuese e ligjore dhe meritën e kandidaturës si dhe organizon seancë dëgjimore publike me kandidatin.

Kuvendi shqyrton kërkesën në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës.

Kur asnjë nga kandidatët, nuk merr shumicën e kërkuar të votave, procedura fillon me kandidatura të tjera nga e para, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.

### ***Kushtet ligjore që parashikon ligji 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”:***

#### **Neni 20**

#### **Kushtet për t’u zgjedhur**

Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të zgjidhet shtetasi shqiptar, që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) ka arsim të lartë në ekonomi, financë **ose drejtësi;**
- b) **përvojë profesionale në çështje financiare;**
- c) **ka kualifikime të larta profesionale** dhe përvojë pune në profesion jo më pak se 10 vjet;
- ç) gëzon integritet të lartë moral dhe profesional;

d) nuk është dënuar më parë për kryerjen e një krimi me vendim gjyqësor të formës së prerë

## **Neni 21**

### **Papajtueshmëritë e funksionit**

1. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, nuk mund të jetë anëtar i Kuvendit, anëtar i Këshillit të Ministrave, i zgjedhur në organet e pushtetit vendor, apo në organet e ndonjë partie ose organizate politike.

Ai nuk mund të kryejë detyra me ose pa shpërblim në subjektet e tjera publike, private apo jofitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies, botimeve dhe veprimtarive kulturore e sportive, me kusht që këto aktivitete nuk dëmtojnë dinjitetin e institucionit dhe nuk cenojnë paanshmërinë dhe pavarësinë e tij.

2. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit fillon detyrën pasi bën betimin përpara Kuvendit.

### ***Analiza paraprake për përputhshmërinë e kritereve ligjore:***

Në lexim të CV dhe dokumentacionit provues, bazuar në kriteret formale ligjore sipas nenit 20 të ligjit 154/2014, Komisioni vlerëson se *kandidati*:

- Plotëson kriterin e arsimimit;
- Ka disa kualifikime për profesionin e ushtruar, në fushën e sigurisë, marrëdhënieve ndërkombëtare;
- Presumohet se ka integritet moral dhe nuk ka dënime të formës së prerë me vendim gjykate për shkak të funksioneve të tij të larta në SHISH dhe më tej në administratën e lartë publike si dhe detyrueshmërisë ligjore për t'u verifikuar në zbatim të ligjeve të posaçme si ligji i dekriminalizimit (138/2015) dhe ai i dokumenteve të ish sigurimit të shtetit (45/2015).
- Nuk rezulton që kandidati gjatë gjithë karrierës së tij, të ketë përvojë profesionale në fushën financiare dhe veçanërisht në çështje të auditimit të jashtëm sipas kuptimit të termit në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Pasja e certifikatës së audituesit publik nuk provon se kandidati e ka ushtruar në profesion dhe nuk mund të konsiderohet si eksperiencë në auditimin financiar në kuptimin e termit të ligjit 154/2014;

- Angazhimet e tjera profesionale të Z.Shaqiri, janë të fokusuar në fushën e sigurisë, të cilat në çdo rast mund të vlerësohen maksimalisht në përputhje me kritere të tjera, por jo në ato të parashikuara nga ligji për KLSH;
- Nuk mund të thuhet se ka kualifikime të larta që rezultojnë me tituj akademikë dhe përvojë të mjaftueshme në fushën financiare

Siç është konsideruar edhe në raporte të mëparshme të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, eksperiencia e posaçme në legjislacionin financiar dhe auditimin financiar, është e domosdoshme dhe e pazëvendësueshme nga eksperiencia të tjera, për arsye të specifikës dhe unicitetit të funksioneve që kryen Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Të gjitha eksperiencat e mëparshme të zotit Shaqiri, janë larg specifikës së çështjeve financiare në përgjithësi dhe auditimit në veçanti si veprimtaritë më të rëndësishme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, (të tilla si “auditimi financiar”, “auditimi i performancës”, “auditimi i përputhshmërisë”, “auditimi i rregullshmërie dhe ai i IT-së”, etj).

Edhe nga analiza e shqyrtimit të dokumentacionit parlamentar, në raste të mëparshme nga ky komision, konstatohet i njëjti vlerësim dhe interpretim i dispozitave të nenit 20, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**Në përfundim të shqyrtimit,** Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në përputhje me nenin 34 të Rregullores së Kuvendit, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, mbështetur në pikën 7, të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i propozon Kuvendit të Shqipërisë, mosmiratimin e kandidaturës së paraqitur me Dekretin nr.11063, dt.19.01.2019, të Presidentit të Republikës, *“Për Propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”*.

Bashkëlidhur projekt-vendimi për rrëzimin e dekretit të lartcitar.

**RELATOR**

**ARBEN AHMETAJ**

**KRYETAR**

**ARBEN AHMETAJ**